



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

Bordi i Administrimit

Nr. 88 Prot

Shkodër, me 10.03 2023

V E N D I M

Nr. 75 datë 10.03 2023

"Për miratimin e trajtimit të veçantë financiar të komisioneve të veçanta të USH-së"

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të larta në Republikën e Shqipërisë" neni 3 pika 1, statuti i USH-së, udhëzimin e MARS nr.29 datë 10.09.2018, VKM nr.6546 datë 31.10.2018 "Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të përhershme të njësisë të qeverisjes qendrore" me vendim të Senatit Akademik nr.58 datë 24.02.2023,

Vendosi:

1. Miratimin e trajtimit të veçantë financiar të stafit akademik (honorare) për punën e bërë jashtë kohës normale të punës për pjesëmarrjen në keshilla dhe komisione të veçanta si më poshtë:
 - Anëtarët këshillit të Etikës-10 000 lekë për çdo mbledhje Këshilli,deri në 6 (gjashtë)mbledhje në vit.
 - Anëtarët e Komisionit të përhershëm për garantimin e standarteve dhe cilësisë së USH-së -10 000 lekë për çdo mbledhje komisioni deri në 4 (katër) mbledhje në vit.
2. Ngarkohet Administratori i USH-së për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari i Bordit të Administrimit

Prof.As.dr. **Adrian LEKA**

